

SI TA MBROJMË PRIVATËSINË NË FACEBOOK ?

Facebook-u ndryshon aq shpesh, ndaj shfrytëzuesit jo gjithmonë arrijnë të mësohen me pamjen (interfejsin) e re, para se ajo të ndryshojë përsëri. Sado që t'i kundërshtojmë këto ndryshime, shumica e shfrytëzuesve mbeten në

këtë rrjet social dhe çdoherë i përshtaten atij nga fillimi. Por, ndryshimet/ parametrat për privatësi nuk janë vetëm mënyrë për t'i paraqitur gjërat. Ato e përcaktojnë mënyrën se si i ndajmë gjërat me të tjerët (përbashkë), me miqtë dhe me publikun e gjerë..

“Udhëzuesi për TKI” i tetë me radhë i fondacionit Metamorfozis ka të bëjë me gjithë shfrytëzuesit e Facebook-ut, pa marrë parasysh mënyrën dhe nivelin se si e shfrytëzojnë këtë rrjet. Ai paraqet “udhëzim të shkurtër për përdorim” të të gjitha opsioneve ekzistuese për mbrojtjen e privatësisë, që është shumë e rëndësishme për ata që i ndajnë shpesh me të tjerët qëndrimet, komentet, linket..., që i shpiejnë te përmbajtjet që u pëlqejnë ose të cilat i përkrahin, te fotografitë personale dhe ato të të tjerëve që janë gjetur para foto-objektivit të tyre.

Edhe pse ky udhëzues, para së gjithash, do t'u ndihmojë shfrytëzuesve të Facebook-ut që t'i kuptojnë mënyrat se si ndahen informatat e tyre me të tjerët dhe si përshtaten opsionet në mënyrë adekuate, sipas preferencave të tyre, megjithatë, përse i përket shfrytëzimit të rrjeteve sociale, ai nuk i përjashton as skeptikët. Se a do të jetë dikush shfrytëzues i ndonjë rrjeti social apo jo, është e drejtë dhe zgjedhje personale, sepse zgjedhja bëhet për shkak të qëndrimeve personale, që duhet të bazohen në nivelin e informimit të drejtë të personit. Ky udhëzues e mundëson mu atë.

Versioni elektronik i këtij botimi, ngjashëm si udhëzuesit tjerë që fondacioni “Metamorfozis” i ka publikuar gjer më tani, gjendet në ueb-faqen e fondacionit: www.metamorphosis.org.mk.

Për versionet në formë të shtypur, shkruani në info@metamorphosis.org.mk.

Ndryshimet në parametrat për privatësi në Facebook, vazhdimisht hapin mundësi të reja për shqetësim, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për të dhënat të cilat ndahen me të tjerët në të ashtuqajturin News Feed apo për mundësitë e teknologjisë së re nëpërmjet së cilës i njohim personat e fotografuar.

Përveç ndryshimeve që i bën vet kompania dhe vështirësive që i kemi për t'i ndjekur ato rregullisht, faktori i dytë i rëndësishëm është se sa në fakt ne ndajmë me të tjerët në Facebook, me kë dhe, ajo që është më e rëndësishme, sa i kuptojmë pasojat e mundshme?

Kompania përpiqet të vendosë një balans ndërmjet ofrimit të më shumë ose më pak opsioneve për përshtatjen e parametrave për privatësi, për shkak se nuk dëshiron t'ua japë kontrollin e plotë shfrytëzuesve, duke u

frikësuar se ata nuk do të duan aspak t'i ndajnë gjërat me të tjerët. Me fjalë të tjera, Facebook-u dëshiron që të ndajmë informacionet me të tjerët, por gjithsesi, duhet t'na e mundësojë që të vendosim vetë për sasinë, përndryshe shumë shpejtë do ta humbim besimin në këtë rrjet social. Disa ekspertë për privatësi, madje thonë se nëse shfrytëzuesit ndjejnë se kanë kontroll mbi atë se çfarë shohin të tjerët, ka më tepër gjasa që të shkëmbejnë informacione.

E vërteta është se me ndryshimet e reja, caktimi i opsioneve është bërë shumë i thjeshtë, por edhe më tej mbetet nevoja që t'i kuptojmë ato, në mënyrë që t'i shfrytëzojmë ashtu siç dëshirojmë.


Bëhuni të sqartë para se të kaloni në faqen tjetër, sa herë i kanë parë parametrat për privatësi në profilin tuaj në Facebook?



PARAMETRAT PËR PRIVATËSI NË PROFILIN E SHFRYTËZUESIT

Më parë, të gjitha informatat personale rregulloheshin në një vend, ndërsa të gjitha parametrat për mënyrën se si i ndani (përbashkoni) ato (kush mund t'i shohë fotografitë, intereset tuaja, etj.) në një vend tjetër (në faqen për përshtatjen e parametrave për privatësi). Tani keni mundësi të vendosni se si do ta ndani ndonjë informatë për veten tuaj, drejtpërdrejt në faqen ku i plotësoni/ndryshoni informatat personale (**About**). Kështu, mund të vendosni që informatat për arsimin, punën dhe ditëlindjen tuaj të jenë të dukshme për një grup të caktuar njerëzish, për shembull për kolegët tuaj, ndërsa intereset për ndonjë muzikë, filmat, citatat etj., të mund t'i shohin vetëm miqtë tuaj më të afërt.

dhe përmbajtje ka qasje. Në mënyrë alternative, mund të klikoni në linkun **public** që ta shihni se si duket profili juaj publik për ata të cilët nuk i keni miq dhe për ata të cilët vetëm janë regjistruar (*Subscribed*) t'i shohin përmbajtjet



Një opcion tjetër i dobishëm është edhe mundësia që ta shihni se si e shohin të tjerët profilin tuaj. Ky opcion ka qenë në dispozicion edhe më parë në faqen me parametrat për privatësi, por tani, çdoherë e keni shumë afër, të pozicionuar në pjesën e epërme të djathtë të faqes së profilin tuaj, gjegjësisht menjëherë nën fotografinë kryesore të *Timeline*-it tuaj.

Në pjesën **Activity Log**, zgjidhni opcionin **View As...** e pastaj në fushën e zbrazët shkruajeni emrin e ndonjë miku që ta kuptoni se si e shoh ai profilin tuaj, gjegjësisht në cilat informata

që i ndani me të tjerët. Nuk është gjë e keqe që këtë ta bëni kohë pas kohe për të qenë të sigurt se parametrat që i keni përkufizuar më parë kanë ngelur të pandryshuar. Këtë kontroll praktikojeni medoemos kur Facebook-u bën ndryshime në parametrat për privatësi, pasi që ato mund të kenë të bëjnë me caktimin e opsioneve standarde (*default*) për profilin tuaj, të cilat mund të jenë të ndryshme nga ato që i keni caktuar herën e fundit.




Njëra nga risitë kryesore gjatë ndryshimeve të rëndësishme në parametrat për privatësi që u bënë kohët e fundit është mundësia që çdoherë kur shfrytëzuesit vendosin staturë, fotografi ose linke të reja, të zgjedhin se me kë dëshirojnë ta ndajnë (përbashkojnë) atë përmbajtje. Opcionet kryesore janë: me gjithë internetin (**Public**), me miqtë (**Friends**), me miqtë përveç të njohurve (**Friends except Acquaintances**), vetëm unë (**Only me**) dhe njerëz të caktuar që do t'i caktoni në mënyrë të veçantë (**Custom**). Me opcionin e fundit mund të jepni leje që përmbajtjet t'i shohin miqtë e miqve tuaj, miqtë që i keni organizuar në ndonjë listë, miqtë e caktuar dhe miqtë që i përmendni dhe i shënoni me tag.

Gjithashtu, me këtë opcion mund ta ndaloni dukshmërinë e përmbajtjes për disa miq ose kategori miqsh. Këto opsione janë paraqitur edhe grafikisht, nëpërmjet ikonave, që i bëjnë gjërat pak më të qarta dhe më të dukshme.

Sa u përket këtyre opsioneve, ka një ndryshim shumë të rëndësishëm në emrin e opcionit për përbashkimin e fotografive, staturave

dhe linkeve tuaja me të gjithë. Në fakt, në vend të emrit të mëparshëm „Everyone”, tani shfrytëzohet emri „Public”, që e bën më të qartë se gjithçka që do të vendosni, do ta ndani me ata që kanë qasje në internet.

Domethënë, çdoherë para se ta shtypni butonin *Post*, keni mundësi të zgjidhni saktësisht se me kë dëshironi ose nuk dëshironi ta ndani përmbajtjen konkrete. Edhe më mirë, nëse harroni ta bëni këtë në fillim, duke klikuar në ikonën e vogël që e simbolizon mënyrën se si është përbashkuar përmbajtja, këtë mund ta bëni edhe më vonë.



Përkundër mundësisë që e keni gjatë përbashkimin të çdo linku, statusi ose fotografie të veçantë, **nuk ka mundësi që të vendosni një nivel të privatësisë për të gjitha postimet që i përbashkoni në profilin tuaj.** Në fakt, që t'i tregoni Facebook-ut se dëshironi që të gjitha përmbajtjet tuaja të ndahen vetëm me miqtë tuaj, këtë duhet ta bëni për çdo përmbajtje veç e veç, para ose pas publikimit.

Në qoftë se për shembull, përbashkoni ndonjë link dhe me këtë rast vendosni që ai të jetë i dukshëm vetëm për miq të caktuar, Facebook-u do ta mbajë mend zgjedhjen tuaj dhe përmbajtjet e ardhshme do t'i përbashkojnë në mënyrë automatike me grupin e njëjtë të miqve, pa pasur nevojë që këtë gjë ta rregulloni përsëri. Funkcionimi i këtillë e kompenson pjesërisht mungesën e opcionit për përbashkim automatik të të gjitha përmbajtjeve në mënyrën e njëjtë, por jo plotësisht. Gjërat që i vendosni në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ueb-faqet,




duke e shtypur sustën *Like* ose komentet që i leni në ueb-faqet që e shfrytëzojnë sistemin për komentim të Facebook-ut, mund të dalin si publike në profilin tuaj. Prandaj, Facebook-u paralajmëron se kur nuk e shihni butonin për ta caktuar mënyrën se si do ta ndani ndonjë përmbajtje, duhet të supozoni se ajo do të jetë publike. Disa lloje të postimeve, thjesht gjithmonë publikohen si publike.

Nga lista rënëse pranë butonit **Home**, zgjidhni **Privacy Settings** dhe në pjesën **Control Your Default Privacy** zgjidhni opcionin që dëshironi, të dobishëm kur përbashkoni nëpërmjet aplikacioneve për Facebook, që nuk kanë opcion për përshtatje veç e veç gjatë përbashkimit të çdo postimi, siç është rasti me BlackBerry-in.


Vëreni emrin e opcionit, **Control Your Default Privacy** (Kontrolloni privatësinë tuaj standarde). Kur do ta hapni faqen për përshtatje të parametrave për privatësi, para syve do t'u dalë kjo pjesë. Nëse merret parasysh emri i pjesës së parametrave për privatësi, mënyra se si është theksuar dhe fakti se shumica e njerëzve nuk i lexojnë detajet, por zgjedhjen e bëjnë në bazë të skenimit të shpejtë paraprak nëpër faqen e hapur, ka gjasa të mëdha që shumë njerëz mos të jenë të vetëdijshëm se mundësia *Friends* nuk do të thotë automatikisht se *Like* i tyre nuk do të jetë në fakt *Public*. Kjo duket si një hap tendencioz nga ana e Facebook-ut për t'na mundësuar kontroll, kurse, nga ana tjetër, i fut disa opsione me të cilat mund të kontrollojmë shumë pak prej asaj që ndajmë me të tjerët.

Nëse Facebook-u kujdeset dhe përpiqet t'na i ofrojë të gjitha mënyrat që ta mbrojmë privatësinë tonë, pse nuk na e mundëson një opcion të vetëm që ta bëjmë zgjedhjen e tillë!? Shfrytëzuesi duhet ta dijë se nëse njëherë e përcakton mënyrën për mbrojtjen e privatësisë, Facebook-u do ta mbajë mend zgjedhjen e tij. Por, kjo automatikisht do të thotë se Facebook-u e detyron shfrytëzuesin të mundohet ta kuptojë si funksionojnë gjërat, që është shumë më e vështirë se sa zgjedhja e një opcionit vetëm me një klik.

Vërejtje: Shfrytëzuesit që kanë bërë ndryshime në parametrat për privatësi, para se Facebook-u të bëjë ndryshime të caktuara, i ndajnë të gjitha përmbajtjet në një mënyrë të caktuar, për dallim nga të tjerët, që, disa përmbajtje për të cilat do të deklarohen se u pëlqejnë, nuk kanë mundësi t'i kufizojnë që të mos jenë publike.



Zgjidhni **Public** në qoftë se dëshironi që të gjitha postimet që i përbashkoni nëpërmjet këtyre aplikacioneve të paraqiten para gjithë publikut, **Friends** që të paraqiten vetëm për miqtë tuaj, ndërsa me **Custom Privacy** mund të përcaktoni vetëm miq të caktuar ose lista me miq me të cilët dëshironi t'i përbashkoni ato, si dhe miq dhe lista me miq prej të cilëve dëshironi t'i fshihni postimet tuaja.






Fusha për përbashkimin e statuseve, linkeve dhe fotografive është pasuruar edhe me disa opsione të tjera për shënimin e lokacionit, vitit dhe miqve. Kjo e lehtëson vendosjen e tag-ut për miqtë me të cilët bëni diçka të përbashkët në atë moment. Kësisoj, në vend që para emrit tuaj ta vëndoni shenjën "@", mjafton ta klikoni ikonën e cila simbolizon shtimin e mikut dhe ta zgjidhni atë nga lista.

Shënimi i lokacioneve precize, paraqet rrezik të madh për prishjen e privatësisë, jo vetëm personale, por edhe të njerëzve të tjerë për të cilët publikisht do të vendosni të tregoni se në atë moment janë me ju. Megjithatë, shumë shfrytëzues edhe më tej dëshirojnë t'i shfrytëzojnë opsionet e këtilla që të lavdërohen për vendet të cilët i vizitojnë.

Është bërë një ndryshim i rëndësishëm sa i përket opsioneve për shkyçje të tag-eve. Sipas Facebook-ut, shfrytëzuesit nuk e kanë pasur shumë të qartë se çfarë domethënie ka pasur kur do ta largojnë ndonjë tag, i cili ka pasur link për tek profili i tyre, prandaj kanë mundur më tepër opsione për këtë gjë.

Opcioni për pranimin/refuzimin e ndonjë tag-u mund të zgjidhet drejtpërdrejt në faqen ku paraqitet fotografia ose postimi (**Options** → **Report/Remove Tag** për fotografit, **Edit or Remove** → **Remove Tag**... për statutet dhe linket). Pasi të zgjidhet shkaku për largimin


e tag-ut, shfrytëzuesi mund të zgjedhë edhe kërkesën plotësuese për heqjen e fotografisë/postimit nga ana e atij që e ka vendosur atë përmbajtje ose ta blloktojë atë.



Që t'i përshtatni opsionet që kanë të bëjnë me shënimin, shkoni në **Privacy Settings** e pastaj në pjesën **Timeline and Tagging** klikoni në **Edit Settings**.

Në dritaren që paraqitet, vëreni opsionin **Review posts friends tag you in before they appear on your timeline (Timeline Review)** i cili mundëson kontroll të tag-eve që i vendosin të tjerët në postimet dhe në fotografitë të cilët ata dëshirojnë t'i përbashkojnë me ju, në Timeline-in tuaj. Në qoftë se ky opcion është i kyçur (**On**), kur miqtë tuaj do t'ju shënojnë, ju duhet ta miratoni përmbajtjen e shënuar para se ajo të paraqitet në profilin tuaj. Ky opcion e pengon paraqitjen e përmbajtjes së tillë në profilin tuaj, por nuk e pengon aspak paraqitjen e saj në Facebook.

Opcioni tjetër që duhet ta aktivizoni në dritaren e njëjtë, **Review tags friends add to your posts on Facebook (Tag Review)**, mundëson kontroll të postimeve tuaja në të cilat miqtë tuaj dëshirojnë të vendosin tag, para se ai të paraqitet në Facebook. Kështu, kur ky opcion është i aktivizuar (**On**) dhe ndonjë mik ju shënon juve ose dikë tjetër në ndonjë përmbajtje, ju duhet ta shqyrtoni para se ajo të



publikohet në Facebook së bashku me tag-un. Nga ana tjetër, nëse dikush që nuk është miku juaj e shënon ndonjë postim tuajin, çdoherë do të duhet ta shqyrtoni dhe ta miratoni para se të publikohet së bashku me shënimin, pa marrë parasysh a e keni opcionin të kyçur ose jo. Pasi ta miratoni tag-un, personi që është i shënuar në fotografinë ose postimin tuaj, si dhe miqtë e tij, do të mund ta shohin atë përmbajtje. Në këtë rast, shfrytëzuesi i i cili bën miratimin, jo vetëm që e përcakton nivelin e mbrojtjes së profilit të tij, por në një mënyrë, fiton rol të ndërmjetësuesit për mbrojtjen e privatësisë së miqtë të tij.

Të dy opcionet janë shumë të ngjashme dhe në shikim të parë mund të shkatohet hut. Dallimi është se në rastin e parë, me opcionin **Timeline Review**, e kontrolloni shënimin e postimeve të huaja, në të cilat të tjerët vendosin tag-e me të cilat ju shënojnë edhe juve, ndërsa me **Tag Review**, lejoni (ose jo) shënimin e postimeve tuaja nga ana e njerëzve të tjerë, pa marrë parasysh se a vëndojnë ata ndonjë tag i cili e lidh profilin tuaj ose profilin e ndonjë miku tuaj. Me opcionin e parë e kufizoni paraqitjen e përmbajtjeve në të cilat ju kanë shënuar në


Account Settings, në pjesën **Notifications**, duhet t'i shënoni opcionet që ju pëlqejnë në pjesët Facebook dhe Photos.

Opcionet tjera në dritaren *Timeline and Tagging* është më mirë të kufizohen së paku në miqtë tuaj (**Friends**), edhe atë:

- f** Me opcionin Who can post on your timeline? mund t'u lejoni ose t'ua ndaloni miqtë të postojnë përmbajtje në profilin tuaj;
- f** Me opcionin tjetër **Who can see what others post on your timeline?** mund ta përshtatni në tërësi se kush mund t'i shohë përmbajtjet që i vendosin të tjerët në profilin tuaj;
- f** Fare në fund, mund ta kufizoni qasjen tek përmbajtjet që i vendosin të tjerët në profilin tuaj së bashku me tag, nëpërmjet opcionit **Who can see posts you've been tagged in on your timeline?**

Varësisht nga miqtë që e përbëjnë listën tuaj dhe situatat konkrete me të cilat mund të ballafaqoheni, mund të keni nevojë të bëni përshtatje të tjera, për shembull t'ua ndaloni

një grupi të caktuar të njerëzve t'i shohin përmbajtjet të cilat i postojnë të tjerët në profilin tuaj. Kështu, nëse miqtë më të afërt dëshirojnë që në profilin tuaj t'i përbashkojnë impresionet nga ahengjet ku keni marrë pjesë së bashku, ndoshta është ide e mirë që t'ua pamundësoni kolegëve ta shohin këtë.



profilin tuaj, ndërsa me opcionin e dytë ndikoni në dukshmërinë e përmbajtjeve për miqtë tuaj dhe miqtë e tyre.

Të gjitha shënimet që e presin miratimin tuaj, paraqiten në një meny të re në profilin tuaj, **Activity Log**. Poashtu, nëse dëshironi që për këto gjëra të merrni njoftime nëpërmjet e-mail-it ose nëpërmjet celularit, në menyne

Duhet theksuar se parametrat për privatësi duhet të mendohen mirë para se të zbatohen. Nuk duhet të shkohet as në skajshmërinë tjetër, që të ndalohet gjithçka nëse nuk ka nevojë reale për një gjë të tillë. Kështu për shembull, ndoshta do të ndiheni më të sigurt në qoftë se e ndaloni që të tjerët të vendosin përmbajtje në profilin tuaj, por hiqni dorë nga ideja e

këtyllë në qoftë se dëshironi të merrni urime për ditëlindjen tuaj.

Opcioni i fundit **Who sees tag suggestions when photos that look like you are uploaded? (Tag Suggestions)** u mundëson miqve tuaj të cilët vendosin fotografi nga ngjarjet në të cilat keni marrë pjesë bashkërisht, të marrin sugjerim që t'ju shënojnë edhe juve,

duke iu falënderuar teknologjisë për njohjen e fytyrave.


Me futjen e të ashtuquajturit *Ticker*, me të cilin risitë paraqiten në anën e djathtë në formë të *feed-it*, paraqiten publikisht të gjitha postimet dhe komentet tuaja që i leni në muret e miqve tuaj, ndërsa postimet tuaja paraqiten edhe në *News Ticker-feed-et* e të tjerëve.

KUFIZIMI I QASJES NË ALBUMET ME FOTOGRAFI

Kur postoni ndonjë album të ri me fotografi, menjëherë mund ta caktoni se sa do të jetë i hapur ai për publikun. Mund ta shënoni datën se kur janë bërë fotografitë e këtij albumi, vendin ku janë bërë, si dhe njerëzit me të cilët dëshironi t'i përbashkoni ato. Poashtu, mund edhe më vonë të bëni ndryshime në parametrat për privatësi të fotografive të vendosura.

Në qoftë se dëshironi ta hiqni tag-un prej ndonjë fotografie, zgjidhni opcionin **Remove** në të djathtë të saj. Në këtë mënyrë vetëm do ta hiqni fotografinë konkrete nga profili juaj, por jo edhe nga profili i atij që e ka vendosur atë. Në qoftë se dëshironi ta paraqisni ndonjë fotografi e cila është e papërshtatshme për arsye serioze (ju shqetëson, paraqet elemente eksplicite, sugjeron shprehje të urrejtjes e të ngjashme) zgjidhni

opcionin **Report/Remove Tag** nga **Options** e pastaj shënoni arsyen e kërkesës për largim e cila do t'ju japë opsione plotësuese për zgjidhjen e rastit.



facebook®



MË TEPËR LISTA PËR KONTROLL MË TË MADH TË PËRBASHKIMIT


Risi të paradokohshme paraqesin dhe listat e mençura që azhurnohen vet duke iu falënderuar të dhënave që i keni futur për arsimin, punën, vendbanimin tuaj, etj., të krahasuara me të dhënat e këtitlla të cilat i kanë futur miqtë tuaj. Po ashtu, këto lista mund të përshtaten edhe në mënyrë manuale.

Në mënyrë opcionale, listën **Close Friends** mund ta azhurnoni edhe në faqen tuaj fillestare në Facebook dhe në të t'i shtoni miqtë më të afërt me të cilët dëshironi të përbashkoni informata të caktuara në mënyrë ekskluzive dhe njëkohësisht të informoheni në mënyrë të filtruar për risitë e tyre.

Mund të krijoni një listë të veçantë për të njohurit të cilët do të paraqiten më pak në *News Feed*-in tuaj, si dhe një listë **Restricted**, anëtarët e së cilës do të mund ta shohin vetëm atë që do ta postoni në mënyrë publike. Miqtë tuaj nuk do ta dinë se a i keni futur në ndonjë listë.

Nëpërmjet linkut **MORE** do të shkoni tek të gjitha listat që i keni krijuar ose listat automatike për menaxhim më të lehtë. Ato mund t'i ndryshoni, t'i fshini, ose të krijoni lista të reja.

Këtu do ta gjeni edhe listën e shfrytëzuesve të bllokuar, si dhe listën e kontakteve telefonike.




NDJEKJA E PËRMBAJTJEVE TË SHFRYTËZUESVE QË NUK JANË MIQTË TUAJ

Kjo është një mundësi e shkëlqyer t'i ndiqni njerëzit e famshëm, gazetarët ose profesionistët e tjerë për punën e të cilëve jeni të interesuar, pa mos qenë e domosdoshme të pranohet kërkesa juaj për miqësi. Kusht për këtë është që profilet e tyre të jenë publike. Në atë rast, shkoni te profili të cilin dëshironi ta ndiqni, në majë të faqes zgjidhni **Subscribe** dhe risitë nga shfrytëzuesi konkret do të vijnë në *News Feed*-in tuaj. Duke klikuar në butonin *Subscribed* mund të caktoni më saktë se cilli lloj i informatave dëshironi t'u vijë në *feed*-in tuaj. Filtrat e këtitllë mund t'i zbatoni edhe për ata që tashmë janë pjesë e rrethit të miqve tuaj, për informatat e të cilëve ju jeni "parapaguar" në mënyrë automatike.

Ky opcion është shumë i mirë në aspekt të dhënies së lirisë më të madhe për informim dhe ndjekjes së aktiviteteve të disa njerëzve, puna e të cilëve është me interes për publikun e gjerë. Nga ana tjetër, në qoftë se ju përbashkoni

publikisht, aktivitetet tuaja do të mund t'i ndjekin drejtpërdrejt në *News Feed*-in e tyre edhe shfrytëzues që nuk janë miqtë tuaj. Prandaj, ky është edhe një opcion për shkak të të cilin duhet të mendoni si dëshironi t'i përbashkoni përmbajtjet tuaja në Facebook dhe përsëri t'i kontrolloni parametrat tuaj kryesorë.

Në qoftë se dëshironi ta pamundësoni parapagimin në profilin tuaj, shkoni në **Account Settings**, zgjidhni tab-in **Subscribers** dhe çyçqni opcionin e parë.




DUKSHMËRIA DHE QASSHMËRIA JUAJ NË FACEBOOK

Edhe pse bëhet fjalë për parametra themelorë, në qoftë se vendosni t'i përkushtoheni mënyrës se si e përbashkoni privatësinë tuaj në Facebook, nuk është keq të filloni nga mënyra se si mund t'u qasen të tjerët juve. Kjo vlen edhe për dukshmërinë e informatave tuaja për të tjerët. Këtë do ta bëni nëpërmjet opcionit **How You Connect** në faqen me parametrat për privatësi. Opcionet që gjenden këtu nuk kanë nevojë për ndonjë sqarim plotësues, prandaj vetëm do t'i përmendim:

- f** Kush mund t'ju kërkojë në Facebook sipas adresës së e-mail-it ose numrit të telefonit që e keni lënë?
- f** Kush ka të drejtë t'ju dërgojë kërkesa për miqësi?
- f** Kush mund t'ju dërgojë porosi nëpërmjet Facebook-ut?

Opcionet që i keni në dispozicion janë të gjithë, miqtë dhe miqtë e miqve tuaj.

Me opcionin **Limit the Audience for Past Posts** nga lista me opsione në faqen me parametra për privatësi, mund ta caktoni dukshmërinë e postimeve tuaja të vjetra të cilat i keni përbashkuar me të gjithë ose me ata që janë në listën tuaj të miqve, por edhe jashtë saj. Me shfrytëzimin e kësaj vegje, ato përmbajtje do të mbeten të përbashkuara vetëm me miqtë tuaj. Nëse konsideroni se ka nevojë për këtë, aktivizojeni këtë opcion, e nëse nuk jeni të sigurt, mendoni paraprakisht, sepse, pasi ta keni zbatuar atë, kthimi në gjendjen paraprake mund të bëhet vetëm hap pas hapi, gjegjësisht postim pas postimi.



QASJA NË TË DHËNAT TUAJA PERSONALE NGA ANA E APLIKACIONEVE TË TJERA DHE UEB-FAQEVE

Një pjesë e informatave për ju, të cilat i përbashkoni publikisht, si dhe lista me miqtë tuaj, shfrytëzohen nga ana e aplikacioneve, lojërave dhe ueb-faqeve të cilat i shfrytëzoni ju dhe miqtë tuaj. Megjithatë, mund të bëni kufizime të caktuara.

Nëpërmjet opcionit **Apps, Games and Websites**, fillimisht me nënopcionin **Apps you use**, mund ta kufizoni qasjen e çdo aplikacioni ose ueb-faqeje veç e veç deri te ndonjë lloj i caktuar i informatave për ju, në qoftë se kjo nuk është e domosdoshme për shfrytëzimin e aplikacionit, si dhe t'i fshini krejtësisht ato

për të cilat më nuk keni nevojë. Këtë duhet ta praktikoni kohë pas kohe, që të mos leni linjë të hapur ndërmjet të dhënave tuaja dhe një numri të madh aplikacionesh mbi të cilat nuk mund të keni kontroll në çdo moment. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se nuk do të mund përsëri të lidheni me ato aplikacione në të ardhmen. Gjithashtu, keni mundësi që aplikacionet t'i shkyçni plotësisht (**Turn off all apps.**) në qoftë se nuk dëshironi t'i jepni informatat kur i shfrytëzojnë miqtë tuaj. Në këtë rast do të pamundësohet lidhja me miqtë në kuadër të lojërave dhe aplikacioneve.



Me nënopsionin e dytë në këtë pjesë, *How people bring your info to apps they use*, mund ta caktoni se cilin lloj të informatave lejoni ta marrin miqtë tuaj kur shfrytëzojnë aplikacione, lojëra dhe ueb-faqe.

Opcioni **Instant personalization** mundëson shfrytëzim të personalizuar të ueb-faqeve të caktuara. Kjo do të thotë se, nëse vizitoni ndonjë faqe të tillë (TripAdvisor, Bing, Rotten Tomatoes), në kuadër të saj do të mund të shihni informata të cilat miqtë tuaj i kanë përbashkuar publikisht deri sa e kanë shfrytëzuar atë ueb-faqe. Gjithashtu, edhe ju mund të përbashkoni informata në këto ueb-faqe të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me profilin tuaj në Facebook. Ky

opcion mundëson socializim dhe personalizim plotësues që vazhdon edhe jashtë vetë aplikacionit të Facebook-ut. Në qoftë se nuk dëshironi ta shfrytëzoni këtë opcion, mund ta shkyçni në fushën **Enable instant personalization on partner websites**.

Në fund, mund ta kufizoni edhe pamjen e profilit tuaj te kërkuesit e interenit, si për shembull Google, kur dikush do ta kërkojë emrin tuaj. Kërkuesit e internetit ruajnë informata kesh, të cilat mund të paraqiten në listën me rezultate nga kërkimi edhe pas ndonjë kohe pasi të jenë publikuar. Sido që të jetë, ekziston opcionin që ta pamundësoni këtë.

facebook 

BLLOKIMI I NJERËZVE DHE I APLIKACIONEVE

Disa njerëz e keqpërdorin shpesh lirinë që e ofrojnë rrjetet sociale dhe qasjen që e kanë te njerëzit duke iu falënderuar atyre. Mirëpo, të tjerët mund të jenë shumë të zënë ose thjesht nuk dëshirojnë që shpesh të pranojnë porosi personale ose ftesa për ndonjë ngjarje ose për shfrytëzim të përbashkët të ndonjë aplikacioni. Prandaj, mund të bllokoni njerëz të caktuar të cilëve dëshironi t'ua ndaloni t'u dërgojnë ftesa të këtilla. Kjo bëhet nëpërmjet opcionit të fundit në faqen për parametra të privatësisë, **Blocked People and Apps**, ku ka 3 nivele (mënyra) të kufizimit të qasjes për interaksion me ju (krejtësisht, nëpërmjet opcionit **Block users** me ç'rast me këta shfrytëzues do të mund të keni interaksion vetëm nëpërmjet

grupeve dhe aplikacioneve të cilat i shfrytëzoni të dytë; **Block app** invites që do t'i ndalojnë ftesat për shfrytëzimin e aplikacioneve nga ndonjë mik konkret; **Block event** invites qo do ta ndalojë dërgimin e fotesave për pjesëmarrje në ngjarje të ndonjë personi të caktuar).

Vërejtje: në qoftë se dëshironi ta kufizoni qasjen deri te informatat që i ndani me miq të caktuar, nuk ka nevojë t'i bllokoni ata. Mjafton që t'i shtoni në listën **Restricted**, të cilës prej këtu mund t'i qaseni nëpërmjet linkut **Edit list**, ose ta gjeni nëpërmjet faqes fillestare të Facebook-ut, duke zgjedhur **MORE** në pjesën **FRIENDS** që gjendet në anën e majtë.

Block users

Once you block someone, that person can no longer be your friend on Facebook or interact with you (except within apps and games you both use and groups you are both a member of).

Names:

Email:

You haven't added anyone to your block list.

Block app invites

Once you block app invites from someone, you'll automatically ignore future app requests from that friend. To block invites from a specific friend, click the "Ignore All Invites From This Friend" link under your latest request.

Block invites from:

You haven't blocked invites from anyone.

Block event invites

Once you block event invites from someone, you'll automatically ignore future event requests from that friend.

Block invites from:

MASAT E TJERA TË SIGURISË

Për mbrojtje plotësuese të të dhënave tuaja, është e pëlqyeshme që ta shfrytëzoni protokolin HTTPS, çdoherë kur kjo është e mundur. Që ta aktivizoni atë, në **Account Settings**, në tab-in **Security**, zgjedhni **Edit** në pjesën **Secure Browsing** dhe aktivizoni opcionin **Browse Facebook on a secure connection (https) when possible**.

Ka mundësi të shfrytëzoni sistem për identifikim të dyfishtë që të jeni të sigurtë se jeni shfrytëzuesi i vetëm në Facebook që

lajmërohet me të dhënat tuaja të shfrytëzuesit. Në vendin e njëjtë, tani zgjidhni **Login Approvals** dhe përzgjidhni opcionin e vetëm me të cilin kërkohet futja e kodit gjithmonë kur ndonjë pajisje e paautorizuar do të përpiqet të lajmërohet në profilin tuaj. Gjithashtu, mund të kërkonte të pranoni njoftime nëpërmjet e-mail-it në qoftë se dikush lajmërohet nëpërmjet kompjuterit ose ndonjë pajisjeje tjetër mobile të cilën ju nuk e keni shfrytëzuar më parë (**Login Notifications**).


Security Settings		
Secure Browsing	Secure browsing is currently disabled.	Edit
Login Notifications	Login notifications are disabled.	Edit
Login Approvals	Approval is not required when logging in from an unrecognized device.	Edit
App Passwords	You haven't created App Passwords.	Edit
Recognized Devices	No recognized devices.	Edit
Active Sessions	Logged in from Skopje, NO REGION, MK and 4 other locations.	Edit



MBROJENI PRIVATËSINË NË GRUPE

Grupet në Facebook mundësojnë lidhje me grupe më të vogla ose më të mëdha të njerëzve nga grupi i miqve, që ofron mundësi për kufizim të komunikimit ndërmjet njerëzve të caktuar. Nga ana tjetër, çdo anëtar i grupit mund të shtojë anëtarë të rinj, në ç'mënyrë privatisia juaj mund të ekspozohet para një publiku të pakontrolluar. Shtimi i anëtarëve bëhet pa pasur nevojë për miratimin tuaj, kështu që mund të gjendeni lehtë në grup me një numër të madh shfrytëzuesish të panjohur, para të cilëve mund të mos jeni të gatshëm të paraqiteni.


Ekzistojnë 3 nivele të grupeve që e kufizojnë dukshmërinë e tyre (**të hapura** – përmbajtja dhe anëtarësia janë të dukshme për të gjithë, **të fshehta** – përmbajtja, anëtarësia dhe dukshmëria kufizohen vetëm tek anëtarët dhe **të mbyllura**, të cilat mund të kërkohen dhe të shihet lista e anëtarëve të tyre, por jo edhe përmbajtja e tyre).



Në qoftë se jeni krijues i grupit, zgjidhni me kujdes se sa do të jetë ai i hapur ndaj të tjerëve dhe, që të jeni të sigurt se shtimi i anëtarëve të rinj nuk do të bëhet në mënyrë të pakontrolluar, përzgjidhni opcionin për të bërë ndryshime te grupi dhe pastaj përzgjidhni opcionin **Any member can add members, but an admin must approve them**. Në këtë mënyrë do të keni kontroll për çdo anëtar të propozuar që duhet të shtohet në grup dhe njëkohësisht do të kontribuoni për mbrojtje më të madhe të privatisisë së postimeve të cilat anëtarët tuaj i përbashkojnë në të.

Që të jeni të sigurt se nuk përbashkoni informata personale dhe qëndrime me njerëz të panjohur, gjithmonë kur të njoftoheni se jeni bërë pjesë e ndonjë grupi, kontrolloni përmbajtjen dhe anëtarësinë e saj. Nëse nuk dëshironi të jeni pjesë e saj, largohuni menjëherë prej tij. Në qoftë se njëherë jeni larguar prej ndonjë grupi, të tjerët nuk do të mund t'ju shtojnë në të.

Kohë pas kohe, nga faqja fillestare në Facebook, në pjesën **GROUPS** klikoni në **MORE** dhe rregullojeni prezencën tuaj në çdo grup ku bëni pjesë.




Mënyra e re e paraqitjes së përmbajtjeve që i ndani me të tjerët në profilin tuaj, bën që gjërat të jenë më të organizuara sipas kohës kur janë publikuar, por gjithashtu ua lehtëson miqve tuaj që të arrijnë deri te ndonjë postim i juaji, të cilin e dinë se kur e keni publikuar. Jo se më parë ka qenë e pamundur të arrihet deri te postimet më të vjetra te profilet e shfrytëzuesve, por klikimi, lëvizja lartë e poshtë dhe pritja që të lexohen postimet më të vjetra, i bën gjërat, nëse jo më të vështira, ë paktën më të ngadalshme dhe më të mërzitshme. Prandaj duhet të keni kujdes se çka do të paraqitni në *Timeline*-in tuaj. Pa marrë parasysh se a keni filluar ta shfrytëzoni apo jo, deshët apo s'deshët, pamja e këtyllë do të vijë edhe te ju, ndaj është mirë t'i keni parasysh rekomandimet e mëposhtme dhe ndryshimin ta prisni të përgatitur.

Bëjeni Timeline-in tuaj privat – Te parametrat për privatësi, klikoni në **How You Connect** dhe në opcionet **Who can post on your timeline?**, **Who can see what others post on your timeline?** dhe **Who can see posts you've been tagged in on your timeline?** përzgjidhni Friends.

Pasi të përfundoni me këtë, kufizoni dukshmërinë e postimeve tuaja të mëhershme, të cilat në ndonjë moment të caktuar i keni bërë publike. Klikoni në **Manage Past Post Visibility** në pjesën **Limit the Audience for Past Posts** dhe zgjidhni **Limit Old Posts** në ç'mënyrë të gjitha postimet tuaja publike automatikisht do të bëhen të dukshme vetëm për miqtë tuaj.

Fshehi postimet e vjetra – Kjo mund t'ju marrë shumë kohë, por nëse e keni me rëndësi se çka do të mendojnë kolegët për ju nëse hasin në ndonjë fotografi tuajën nga viti 2007, atëherë është mirë t'i kushtoni pak kohë "pastrimit". Shqyrtojeni çdo postim veç e veç, dhe në qoftë se është i papërshtatshëm që të duket në *Timeline*-in tuaj, fsheheni atë. Në qoftë se dëshironi të jeni të sigurt se ndonjë postim do të fshihet përgjithmonë, në atë rast zgjidhni **Delete...**

Fshehja e postimeve nga *Timeline*-i juaj do t'ju shpëtojë nga paraqitja e përmbajtjeve që mund t'ju turpërojnë dhe t'u fusin në situata të pakëndshme,




por kjo nuk do të thotë se ato nuk mund të rikthehen dhe t'ju shkaktojnë telashe gjatë ridizajnit të ardhshëm të Facebook-ut.

Fshini postimet tuaja nga profilet e huaja –

Nuk mund të keni kontroll mbi atë që e publikoni në profilet e huaja. Prandaj, nëse dëshironi të gjurmoni nëpër të kaluarën dhe të siguroheni se atje nuk ka dëshmi për "jetën tuaj të kaluar", klikoni në **Activity Log** dhe pastaj nga lista rënëse **All** në këndin e djathtë, zgjidhni **Your Post**. Kjo do t'u mundësojë paraqitjen e të gjitha shënimeve dhe linkeve të cilat i keni vendosur te muret e të tjerëve, si dhe mundësinë që t'i fshini ato. Këto postime nuk mund t'i fshehni aq thjeshtë, sepse gjenden në profilet e huaja dhe pronarët e tyre e kanë kontrollin e plotë mbi to.

Kontrolloni rregullisht se çka keni ndarë me të tjerët (përbashkuar) –

Bëjeni shprehi të kontrolloni se çka keni përbashkuar në *Timeline*-in tuaj, çdo 2-3 javë dhe fshihni në mënyrë adekuate ose kufizojeni dukshmërinë e postimeve të caktuara. gjersa e bëni këtë, shihni se si duket profili juaj për të tjerët (klikoni në të djathtë të **Activity Log**, zgjidhni **View as...** dhe shkruani ndonjë emër ose zgjidhni **public** që të shihni se si duket profili juaj edhe për ata që nuk janë në rrethin e miqve tuaj).





GJËRA QË DUHET T'Ë DINI

- f** Facebook-u merr njoftim çdoherë kur do ta vizitoni ndonjë ueb-faqe që e ka butonin *Like*, edhe atëherë kur nuk do të klikoni në të, nuk jeni të lajmëruar ose kur nuk jeni shfrytëzues i Facebook-ut.
- f** Edhe sikur ta kufizoni qasjen në informatat tuaja, që ato të jenë të dukshme vetëm për miqtë tuaj, disa prej tyre mund t'i shfrytëzojnë ndonjë aplikacion, i cili mund të lejojë transferimin e të dhënave tuaja te pala e tretë pa dijen tuaj.
- f** Pasi ta fshini profilin tuaj, për të cilën gjë nevojitet një muaj, disa informata mund të mbeten te kompjuterët e Facebook-ut deri në 90 ditë.
- f** Përbashkimi i informatave me miqtë e miqve tuaj mund t'i ekspozojë ata para mijëra njerëzve të panjohur.
- f** Emri juaj dhe fotografia e profilit janë publike. Në qoftë se dëshironi ta fshehni identitetin tuaj, mos përdorni fotografi e cila ju identifikon. Informatat tjera që kanë karakterin e informatave publike janë rjetet ku lidheni, emri juaj si shfrytëzues dhe ueb-faqja juaj.
- f** Me deaktivizimin e profilit tuaj, Facebook-u edhe më tej i ruan të gjitha informatat tuaja, ndërsa profilin e bën vetëm përkohësisht të paqasshëm. Fshirja e profilit do ta bëjë atë të paqasshëm përgjithmonë.
- f** Atë që do të vendosni ta ndani publikisht, e ndani me gjithë publikun që ka qasje në internet, e jo vetëm me ata që janë në Facebook.
- f** Ekzistojnë postime që çdoherë publikohen si publike. Në qoftë se nuk keni mundësi të zgjidhni se me kë do të ndani diçka, duhet të supozoni se ajo do të ndahet me gjithë publikun.
- f** Atë që të tjerët e ndajnë e që ka të bëjë me ju, nuk është nën kontrollin tuaj. Të tjerët mund të vendosin t'i ndajnë informatat e tyre në mënyrë publike, nëse ndajnë diçka që ka të bëjë me ju, kontrolli është në duart e tyre.
- f** Kur në postimin tuaj do të vendosni tag për ndonjë mik tuajin, ai dhe të gjithë miqtë e tij do të mund ta shohin përmbajtjen konkrete, pa marrë parasysh se me cilin publik keni vendosur ta bëni ndarjen. E njëjta vlen edhe kur do të miratoni ndonjë tag që dikush tjetër e ka vendosur për ju.
- f** Mendoni para se të publikoni diçka. Si gjithçka gjë tjetër në internet, përmbajtjet që do të publikohen njëherë, mund të kopjohen dhe të ripublikohen nga ana e shfrytëzuesve të tjerë.
- f** Kur komentoni ose kur shtypni *Like* në postimin e dikujt, personi që e ka futur postimin e përcakton publikun e tij.
- f** Në qoftë se jeni të shënuar me *tag* në kuadër të ndonjë grupi të kufizuar, vetëm anëtarët e atij grupi do të mund ta shohin *tag*-un.
- f** Nëse i ndani informatat tuaja për kontakt, si për shembull adresën e e-mail-it dhe numrin e telefonit, me miqtë tuaj, ata mund t'i sinkronizojnë këto të dhëna me aplikacione të tjera, si ato që i kanë në celularët e tyre.
- f** Faqet e Facebook-ut janë publike. Kur leni ndonjë koment ose *Like* në përmbajtjet e tyre, kjo është e dukshme për të gjithë.
- f** Atë që e lexuat në këtë udhëzues vlen për parametrat aktuale për privatësi në Facebook (maj, 2012). Ato përsëri do të ndryshojnë dhe ju përsëri do të duhet të merreni me to.

Linke të dobishme:

http://www.facebook.com/full_data_use_policy

- ➔ tekst i gjatë, por paraqet një pasqyrë të plotë për mënyrën se si Facebook-u i shfrytëzon të dhënat e shfrytëzuesve

<https://www.facebook.com/safety>

- ➔ këshilla dhe vegla për siguri për tinejxherët, prindërit dhe arsimtarët

<http://www.hildenoaks.co.uk/suggested-facebook-privacy-settings.php>

- ➔ udhëzues hap pas hapi për mbrojtjen e privatësisë në Facebook, që azhurnohet gjatë çdo ndryshimi në parametrat për privatësi

<http://www.facebook.com/about/sharing>

- ➔ udhëzues i shkurtër për ndarjen (përbashkimin) në Facebook + video

<http://www.facebook.com/about/tagging>

- ➔ udhëzues i shkurtër për shfrytëzimin dhe largimin e tag-eve

<http://epic.org/privacy/facebook>

- ➔ lajme, vegla dhe uhdëzime për mbrojtjen e privatësisë në Facebook

Botues:

METAMORPHOSIS 

Për botuesin: **Bardhyl Jashari**

Autore: **Irina Shumadieva**

Përktheu: **Valon Abdiu**

Lekturoi: **Fatmir Sulejmani**

Përpunimi grafik: **brigada.mk**

Autorja dhe fondacioni Metamorfozis janë pronarë të të drejtave autoriale të teksteve që janë publikuar në këtë udhëzues.



Në formë digjitale, përmbajtjet janë publikuar nën licencën Creative Commons – Thekso burimin – Ndaj nën kushte të njëjta 2.5 Maqedoni

<http://creativecommons.org/licenses/by-sa/2.5/mk>

Metamorfozis është fondacioni i pavarur, jopartiak dhe joprofitabil me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë. Misioni i fondacionit Metamorfozis është të kontribuojë në zhvillimin e demokracisë dhe në përmirësimin e kualitetit të jetesës nëpërmjet zbatimit inovativ dhe përhapjes së dijes. Vlerat tona kryesore janë të qenit të hapur, barabarësia dhe liria.

Adresa për kontakt

„Metamorfozis“

rr. "Apostoll Gusllarot" nr. 40

1000 Shkup, Maqedoni

tel/faks: +389 2 3109 325

e-mail-i: info@metamorphosis.org.mk

ueb-faqja: www.metamorphosis.org.mk

Ky botim është përkrahur nga Fondacioni shoqëri e hapur – Maqedoni në kuadër të projektit "Si deri te privatësia në internet?"



CIP - Katalogizacija vo publikacija

Nacionalna i univerzitetaska biblioteka "Sv. Kliment Ohridski", Skopje

342.738.037:004.773.6/.7(036)

SHUMADIEVA, Irina

Si ta mbrojmë privatësinë në facebook? / [autorë Irina Shumadieva] ; [përktheu Valon Abdiu]. - Skopje : Fondacija Metamorfozis, 2012. - 16 str. : ilustr. ; 30 cm. - (Udhëzues për TKI i Metamorfozis ; nr. 8)

Превод на делото: Како да си ја заштитиме приватноста на фејсбук? / автор Ирина Шумадиева

ISBN 978-608-4564-35-5

1. Шумадиева, Ирина види Shumadieva, Irina

а) Право на приватност на фејсбук - Заштита - Водичи

COBISS.MK-ID 91505674